



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1096 Prot.

Tiranë, më 19.1. 2018

**REKOMANDIM**

“MBI MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË REGJISTRIT TË PARASHIKIMIT PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “ME NEGOCIM PASHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS”, AMENDAMENTEVE TË KONTRATËS, SI DHE OBJEKTEVE ME VLERË NËN 100.000 LEKË

**Drejtuar:** Gjithë Autoriteteve Kontraktore

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 4 dhe 36 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Udhëzimit të APP Nr. 01, datë 05.01.2018, si dhe Udhëzimit të APP Nr. 2, datë 08.01.2018, Agjencia e Prokurimit Publik rekomandon autoritetet kontraktore, si më poshtë vijon:

1. Në krijimin e regjistrit të parashikimit, për procedurën e prokurimit “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, përveç elementeve të parashikuara në formatin Nr. 1, bashkëlidhur Udhëzimit të APP Nr. 01, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit publik dhe krijimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, autoriteti kontraktor gjatë plotësimit të regjistrit të parashikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të ketë parasysh që për këtë lloj procedure duhet të japë edhe arsyet e përzgjedhjes së saj.

Në dhënien e justifikimit, autoriteti kontraktor duhet të mbështetet në parashikimet e nenit 33 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe sidomos, në kushtet e detajuara mbi përdorimin e kësaj procedure prokurimi, sipas parashikimeve të Udhëzimit të APP Nr. 2, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit “Me negociim pashpallje paraprake të njoftimit të kontratës” dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Në këtë kuptim, publikimi i elementëve të regjistrit të parashikimit të krijuar për këtë procedurë prokurimi nga APP do të bëhet vetëm nëse nga autoriteti kontraktor jepen arsye ligjore për përzgjedhjen e kësaj procedure prokurimi. Konkretisht,

a) Nëse procedura e prokurimit “negociim pa shpallje paraprake e njoftimit të kontratës është përzgjedhur sipas parashikimeve të nenit 33 pika 2/a të LPP atëherë, në sistemin e prokurimit elektronik si justifikim për përdorimin e kësaj procedure duhet të vendoset argumenti ligjor:

i) Në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme mbi apo nën kufirin e ulët monetar **nuk është dorëzuar asnjë** ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje;

b) Nëse procedura e prokurimit “negociim pa shpallje paraprake e njoftimit të kontratës është përzgjedhur sipas parashikimeve të nenit 33 pika 2/b të LPP atëherë në sistemin e prokurimit elektronik si justifikim për përdorimin e kësaj procedure duhet të vendoset argumenti ligjor:

i) Jemi përpara mungesës së konkurrencës në treg për arsye që lidhen me mbrojtjen e së drejtën e ekzkluzivitetit apo mbrojtjes të së drejtës së autorit, vërtetuar nga autoritetet përkatëse shtetërore sipas legjislacionit në fuqi.

c) Nëse procedura e prokurimit “negociim pa shpallje paraprake e njoftimit të kontratës është përzgjedhur sipas parashikimeve të nenit 33 pika 2/c të LPP atëherë në sistemin e prokurimit elektronik si justifikim për përdorimin e kësaj procedure duhet të vendoset argumenti ligjor:

- Ekzistojnë për autoritetin kontraktor njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- i) Është shkaktuar një ngjarjeje e paparashikuar;
- ii) Autoriteti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen;
- iii) Ngjarja dëmton interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë;
- iv) Nuk ka qenë e mundur të ndiqen procedurat standarde mbi ose nën kufirin e ulët monetar.

ç) Nëse procedura e prokurimit “negociim pa shpallje paraprake e njoftimit të kontratës është përzgjedhur sipas parashikimeve të nenit 33, pika 3/a të LPP, atëherë në sistemin e prokurimit elektronik si justifikim për përdorimin e kësaj procedure duhet të vendoset një nga rastet e mëposhtme:

- i) Mallrat prodhohen vetëm për qëllime kërkimi; ose
- ii) Mallrat prodhohen vetëm për qëllime eksperimentimi; ose
- iii) Mallrat prodhohen vetëm për qëllime studimi ose zhvillimi.

d) Nëse procedura e prokurimit “negociim pa shpallje paraprake e njoftimit të kontratës është përzgjedhur sipas parashikimeve të nenit 33, pika 3/b të LPP atëherë në sistemin e prokurimit elektronik si justifikim për përdorimin e kësaj procedure duhet të vendoset argumenti ligjor:

- Autoriteti kontraktor është përpara situatës së:

- i) zëvendësimin të pjesshëm i furnizimeve normale, ose
- ii) zëvendësimin të pjesshëm i instalime në përdorim, ose
- iii) shtesës së furnizimeve ose instalimeve ekzistuese.
- iv) nuk ka kaluar 3-muaj nga përfundimi i kontratës fillestare;
- v) vlera e kontratës shtesë nuk është më shumë se 20% e vlerës së kontratës fillestare (të jepet informacion mbi kontratën bazë dhe Nr.Referencës)

**dh)** Nëse procedura e prokurimit “negociim pa shpallje paraprake e njoftimit të kontratës është përzgjedhur sipas parashikimeve të nenit 33 pika 5/a të LPP atëherë në sistemin e prokurimit elektronik si justifikim për përdorimin e kësaj procedure duhet të vendoset argumenti ligjor:

- i) Autoriteti kontraktor ka nevojë për punë/shërbime shtesë, të cilat janë të domosdoshme për përfundimin e kontratës fillestare;
- ii) Autoriteti kontraktor ka nevojë për punë/shërbime shtesë të shkaktuar nga rrethana të paparashikuara që nuk varen nga autoriteti kontraktor
- iii) Këto punë /shërbime shtesë nuk mund të ndahen teknikisht ose ekonomikisht, nga kontrata fillestare, pa sjellë ndikime negative ose kosto të mëtejshme për autoritetin kontraktor;
- iv) Kontrata shtesë po lidhet me kontraktorin që po zbaton kontratën;
- v) Vlera e plotë e kontratës shtesë nuk tejkalon 20% e vlerës së kontratës fillestare, (të jepet informacion mbi kontratën bazë dhe Nr.Referencës);
- vi) Nëse është planifikuar fond rezervë, shtesa është parashikuar, pas ezaurimit të këtij fondi.

**e)** Nëse procedura e prokurimit “negociim pa shpallje paraprake e njoftimit të kontratës është përzgjedhur sipas parashikimeve të nenit 33 pika 5/b të LPP, atëherë në sistemin e prokurimit elektronik si justifikim për përdorimin e kësaj procedure duhet të vendoset argumenti ligjor:

- i) Autoriteti Kontraktor ka nevojë për punë/shërbime të reja, që kanë të bëjnë me përsëritjen e punëve/shërbimeve të ngjashme;
- ii) Këto punë /shërbime të reja që do të prokurohen janë në përputhje me projektin bazë të kontratës fillestare, të lidhur pas zhvillimit të një procedure të hapur apo të kufizuar;
- iii) Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure është parashikuar në njoftimin e kontratës fillestare dhe autoriteti kontraktor ka vlerësuar koston e përgjithshme, të përlllogaritur, të ndërtimeve ose shërbimeve në vijim;
- iv) Kontrata shtesë do të lidhet me kontraktorin që po zbaton kontratën;
- v) Afati për lidhjen e kësaj kontrate shtese është brenda 3 viteve nga lidhja e kontratës fillestare;
- vi) Vlera e plotë e kontratës shtesë nuk tejkalon 20% e vlerës së kontratës fillestare (të jepet informacion mbi kontratën bazë dhe Nr.Referencës).

Sjellim në vëmendje që kjo lloj procedure prokurimi nuk mund të përdoret për ato kontrata, për të cilat parashikohet shërbim i vazhdueshëm.

f) Nëse procedura e prokurimit “negociim pa shpallje paraprake e njoftimit të kontratës është përzgjedhur sipas parashikimeve të nenit 33 pika 4 të LPP atëherë në sistemin e prokurimit elektronik si justifikim për përdorimin e kësaj procedure duhet të vendoset argumenti ligjor:

i) kandidat i suksesshëm i dalë në përfundim të konkursit të projektimit.

2) Sa i takon pasqyrimin në regjistrin e parashikimeve të amendamentit të kontratës për mallrat apo shërbimet e vazhdueshme, vlera e të cilave nuk mund të kalojë 20% të kontratës së fundit të lidhur pas përfundimit të një procedure konkurruese sqarojmë se, në regjistrë duhet të pasqyrohen të dhënat e kontratës bazë (objekti, vlera e kontratës, data e nënshkrimit të saj, data e përfundimit, etj.), për të cilën po bëhet ky amendim kontrate.

3) Për objekte, mallra dhe shërbime, të cilat janë parashikuar të zhvillohen me vlerë nën 100,000 (njëqind mijë) lekë, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë parasysh se vlera e përlllogaritur e mallrave dhe shërbimeve të ngjashme brenda një viti kalendarik, nuk duhet të jetë më e madhe se 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky argumentim duhet të jepet edhe në regjistrë, sipas formës të mëposhtme:

-Për këtë objekt prokurimi, artikull/grup artikujsh nevojat e autoritetit kontraktor nuk e kalojnë vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë gjatë gjithë vitit.

**Së fundmi**, APP tërheq vëmendjen e autoriteteve kontraktore për të respektuar me përpikmëri parashikimet nënligjore të përcaktuara në Udhëzimin e APP Nr. 01, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit publik dhe krijimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, dhe në Udhëzimin e APP Nr. 2, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit “Me negociim pashpallje paraprake të njoftimit të kontratës” dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**Reida Kashta**